



UNMIK



**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me Rregulloren 2001/9, neni 1.3 pika (ç) mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh neni 3 dhe 4 të Rregullores 2001/35 për Pensionet në Kosovë,

Me qëllim të evitimit të keqpërdorimeve të ndryshme nga shfrytëzuesit e pensioneve bazë, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 07 /2006  
PËR**

**PLOTËSIMIMIN E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 2/2003 LIDHUR MË  
NDALESAT E PAGESAVE SË PENSIONIT BAZË PËR RASTET KUR  
PENSIONISTËT VDESIN**

**Neni 1**

**Lajmërimi i pensionistëve**

Pas nenit 5 shtohet neni 6 me këtë përmbajtje:

**6.1.** Shfrytëzuesit e pensionit bazë janë të obliguar që të lajmërohen personalisht ose përmes personit të autorizuar dy herë në vit (një herë në gjashtë muaj) në zyrët rajonale të Departamentit të Administratës Pensionale të MPMS-së.

Më rastin e lajmërimit shfrytëzuesi i pensionit bazë duhet të sjellë me vete këto dokumente identifikuese:

-Letërnjoftimin e UNMIK-ut;  
-Fletë autorizimin nëse pensionisti e autorizon përfaqësuesin e tij,  
-vërtetimin se shfrytëzuesi i pensionit është gjallë nga organi kompetent komunal ( kur shfrytëzuesi i pensionit e autorizon përfaqësuesin e tij për marrjen e pensionit ) .

**6.2** Nëse shfrytëzuesi i pensionit bazë nuk lajmërohet në zyrën rajonale të DAPK-së,siç është përcaktuar në paragrafin 6.1. të këtij neni ai nga DAPK-ja do të suspendohet përkohësisht në shfrytëzimin e pensionit bazë.

**6.3** Nëse në afat prej 30 ditësh,nga dita e marrjes së vendimit për suspendimin nga pensioni bazë,pensionisti përsëri nuk lajmërohet,atij do ti ndërpritet e drejta e mëtejme në shfrytëzimin e pensionit bazë.

**6.4.** Shfrytëzuesi i pensionit,për të fituar sërish të drejtën në pensionin bazë,duhet të ri aplikoj në përputhje me dispozitat e Rregullores 2001/35 mbi pensionet në Kosovë dhe rregullat e përcaktuara nga DAPK-ja e MPMS-së.

**6.5** E drejta sërish në shfrytëzimin e pensionit bazë shfrytëzuesit të pensionit do ti njihet nga dita e ri aplikimit.

## **Neni 2**

### **Ndryshimi i neneve të Udhëzimit Administrativ**

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ nr. 02/2003 lidhur më ndalesat e pagesave të pensionit bazë në rastet kur pensionistët vdesin bëhet 7,neni 7 bëhet 8,neni 8 bëhet 9,neni 9 bëhet 10 dhe neni 10 bëhet 11.

## **Neni 3**

### **Teksti i spastruar i Udhëzimit Administrativ**

Për shkaqe praktike dhe për një zbatim të drejtë dhe efikas të këtij akti obligohet DAPK-ja që në afatin prej 7 ditësh pas nënshkrimit të këtij akti,këto plotësime ti inkorporoi në tekstin e spastruar të Udhëzimit Administrativë nr. 02/2003.

## **Neni 4**

Udhëzimi administrativë nr. 8/2006 për plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2003 lidhur më ndalesat e pagesave të pensionit themelor në rastet kur pensionistët vdesin, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

**Prishtinë, shtator 2006**

**Ministri i MPMS-së  
Ibrahim Selmanaj**

---